



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut (KMI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Vlera e detyrimeve kontingjente në PVF ishte mbivlerësuar për 101,944€.
- A2 Vlera e llogarive të arkëtueshme në PVF ishte nënvlerësuar për 18,582€.
- A3 Regjistri i pasurisë në PVF ishte nënvlerësuar për 2,824,090€ si rrjedhojë e klasifikimit të pasurive në klasa jo përkatëse në regjistrin kontabël.
- B1 Nga thesari përmes përmbarimit dhe vendimeve gjyqësore ishin realizuar pagesa në vlerë 593,680€ nga kategori ekonomike jo adekuate duke shkaktuar keqklasifikim të shpenzimeve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Mitrovicës së Jugut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A4 Në pesë (5) raste kemi vërejtur mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave të prokurimit.
- B2 Komuna nuk kishte kryer verifikimin e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.
- B3 Në nëntë (9) pagesa me vlerë prej 327,325€ kemi vërejtur se faturat ishin vonuar për pagesë përtej afatit ligjor prej 30 ditësh.
- C1 Në dy (2) kontrata publike kornizë me çmime për njësi, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkaluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mitrovicës së Jugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Mitrovicës së Jugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Çështjet më me fokus dhe që kanë ndikuar në opinionin financiar të auditimit janë ato që kanë të bëjnë me klasifikimin jo të duhur të shpenzimeve, paraqitjen jo të drejtë dhe jo të saktë të detyrimeve kontingjente, pasurive jofinanciare, dhe llogarive të arkëtueshme.

Fusha për përmirësim të mëtejshëm janë identifikuar tek menaxhimi jo i mirëfilltë kontratave publike dhe mangësitë në procesin e vlerësimit të ofertave gjatë procedurave të prokurimit.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Në bazë të mostrave të testuara, shuma e pagesave të realizuara nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore për kontratën kolektive dhe pagat jubilarë ishte 593,680€. Prej tyre, borxhi kryesor ishte 323,403€, ndërsa 270,277€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbarimit.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre shtatë (7) janë rekomandime të reja, pesë (5) rekomandime të përsëritura dhe një (1) rekomandim pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontingjente në pasqyrat financiare vjetore (PFV)

Gjetja	Sipas nenit 18 të Rregullores nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.
	Gjatë auditimit të detyrimeve kontingjente të raportuara në PFV, në dy raste [*] është konstatuar se shumat e raportuara nuk ishin të sakta. Më konkretisht, detyrimet kontingjente ishin mbivlerësuar në shumën prej 101,944€, duke tejkaluar vlerën reale.
	Kjo kishte ndodhur për shkak të gabimeve teknike nga Avokati i Komunës, gjatë procesit të llogaritjes dhe përgatitjes së listës së detyrimeve kontingjente që duhej përfshirë në pasqyrat financiare.
Ndikimi	Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së PFV-ve detyrimet kontingjente të shqyrtohen me kujdes, të vlerësohen në përputhje me dokumentacionin mbështetës dhe të raportohen me vlera të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Prezantim jo i drejtë llogarive të arkëtueshme në PFV

Gjetja Sipas nenit 16 të Rregullores MF-nr.01/2017 për raportim vjetor financiar për organizata buxhetore, është përcaktuar që OB-të që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të plotë për shumat e paarkëtuara.

Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme, është vërejtur prezantim i pasaktë i të dhënave në PFV, konkretisht:

Në (3) raste tek llogaritë e arkëtueshme nga qiraja, është identifikuar nënvlerësim në vlerë totale prej 18,582€. Në dy (2) raste në vlerë prej 16,999€, nënvlerësimi ka rezultuar nga mungesa e evidencave të kartelave individuale financiare që nga viti 2019. Ndërkaq, në rastin e tretë në vlerë prej 1,583€, nënvlerësimi ka ndodhur për shkak të mos pagesës së plotë të qirasë nga operatori ekonomik, me arsyetimin se ishte ndalur tatimi në burim për një periudhë të caktuar. Kjo diferencë nuk ishte identifikuar dhe nuk ishte reflektuar në PFV.

Këto pasaktësi kanë ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme efektive. Kjo tregon se nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar përditësimin dhe saktësinë e të dhënave të raportuara.

Ndikimi Shpalosja jo e saktë e llogarive të arkëtueshme ndikon në raportimin financiar jo të drejtë dhe të saktë duke ndikuar në nënvlerësim të tyre në PFV.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në harmonizimin e evidencave të brendshme me të dhënat e raportuara, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme dhe raportimit të saktë dhe të plotë të tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mbivlerësim/nënvlerësim i regjistrit të pasurisë në pasqyrat financiare vjetore (PFV)**Gjetja**

Sipas nenit 11 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcaktohet se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim". "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi".

Ndërsa, sipas nenit 10, përcaktohet se të gjitha pasuritë jo financiare pas pranimit në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore, pavarësisht se a janë paguar apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël dhe të jenë objekt i inventarizimit dhe vlerësimit.

Gjatë auditimit identifikuam se regjistri i pasurisë ishte mbivlerësuar për 360,671€, si rezultat i mangësive si në vijim:

- Tri (3) pasuri që lidhen me projekte kapitale të përfunduara në vitet e mëhershme në vlerë 91,808€, janë gabimisht të klasifikuara si investime në vijim. Duhej të klasifikoheshin si pasuri në përdorim me vlerë neto prej 50,494€ pas aplikimit të zhvlerësimit prej 41,314€. Si pasojë, pasuritë janë mbivlerësuar për 41,314€;
- Tri fatura në vlerë neto 43,650€, janë regjistruar gabimisht si pasuri në përdorim, ndonëse nuk përbëjnë pasuri kapitale. Këto pagesa janë pagesa të keq klasifikuara të cilat nuk plotësojnë kriteret për pasuri kapitale. Si rezultat, pasuritë janë mbivlerësuar për 43,650€;
- Një (1) pasuri që lidhet me rindërtimin e shtëpive në kroin e Vitakut në veri të Mitrovicës është e përfshirë në regjistrat e pasurive me efektin neto prej 158,623€. Sipas dëshmive të ofruara nga Komuna, kjo pasuri nuk i takon komunës dhe si e tillë nuk duhej të ishte pjesë e regjistrit kontabël. Kjo ka shkaktuar mbivlerësim të regjistrit për 158,623€;
- Një (1) pasuri në vlerë neto prej 117,084€ e kishte mbivlerësuar regjistrin e pasurisë për të njëjtën vlerë, si pasojë e regjistrimit të gabuar të saj; dhe
- Një (1) pasuri në vlerë prej 110,232€ është e regjistruar si kategorinë e investimeve në vijim, ndërkaq kjo pasuri do të duhej të ishte klasifikuar si pasuri në përdorim. Në këtë rast, zhvlerësimi nuk është aplikuar, por për shkak të kohës së regjistrimit, ky efekt pritët të reflektohet në vitin vijues.

Në anën tjetër, regjistri i pasurisë ishte nënvlerësuar për vlerën neto prej 3,184,761€ për faktin se:

- Testimet tona kanë evidentuar se Komuna e Mitrovicës nuk ka bërë regjistrimin e plotë të pasurisë për "Ndërtimin e impiantit të mbeturinave ricikluese", projekt ky i realizuar me bashkëfinancim nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Vlera e kontratës bazë për këtë projekt ishte 3,395,070€, ndërsa përmes një aneks-kontrate ishin alokuar edhe 339,270€ shtesë. Ministria ka kontribuar në vlerën e financimit prej 3,500,000€, ndërsa Komuna, sipas marrëveshjes së mirëkuptimit, ka kontribuar përmes dhënies së truallit dhe përmbushjes së obligimeve shtesë që lidhen me realizimin

e projektit. Procesi i punimeve dhe implementimit të projektit ka përfunduar me pranimin teknik nga Komisioni përkatës më 19 dhjetor 2019. Më tej, më 29 korrik 2020, është bërë kompletimi i defekteve të evidentuara gjatë inspektimit final, me ç' rast është konfirmuar nga menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës se punimet janë përmbyllur plotësisht. Megjithatë, pavarësisht përfundimit të projektit dhe funksionalitetit të impiantit, kjo pasuri në regjistrat kontabël të pasurisë është e regjistruar si investim në vijim që nga viti 2020, në një vlerë prej 100,000€. Ky regjistrim jo i plotë ka rezultuar në nënvlerësim neto të pasurisë komunale për shumën prej 3,167,548€; dhe

- Në 13 raste ishte bërë nënvlerësimi i pasurisë në vlerë prej 17,213€ si pasojë e regjistrimit të gabuar të pasurisë në kategorinë e pasurisë në përdorim, përderisa projektet ende nuk kishin përfunduar dhe nuk ishte bërë pranimi teknik i tyre.

Mangësitë e identifikuar kanë ardhur si rezultat i mosfunksionimit të duhur të kontroleve të brendshme në menaxhimin e pasurisë, mungesës së bashkëpunimit ndërmjet drejtorive përkatëse, si dhe mungesës së dokumentacionit të plotë për projektet e bashkëfinancuara. Gjithashtu, janë evidentuar probleme në aplikimin e duhur të rregullave për klasifikim dhe zhvlerësim të pasurisë.

Ndikimi

Gabimet në regjistrimin e pasurive, mos regjistrimi i tyre në klasat e duhura të pasurisë si dhe kapitalizimi i pasurisë të cilët nuk e plotësojnë kriterin e shpenzimeve kapitale ka ndikuar në mbivlerësim/nënvlerësim të regjistrave të pasurisë si dhe paraqet prezantim jo të drejtë dhe të saktë të pasurisë në PFV.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që të rishikojë tërësisht regjistrin kontabël të pasurive dhe të bëjë korrigjimet e nevojshme për rastet e mbivlerësimit dhe nënvlerësimit, të sigurojë që pasuritë e përfunduara të klasifikohen si pasuri në përdorim dhe t'u aplikohet zhvlerësimi sipas rregullave përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013, shpenzimet duhet të regjistrohen në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Në shtatë (7) raste kemi vërejtur keqklasifikim të shpenzimeve në vlerë totale prej 593,680€, ku pagesat janë realizuar nga kategori ekonomike jo adekuate. Nga kjo vlerë, për mostrat e testuara, kemi konstatuar se Thesari ka ekzekutuar pagesa sipas vendimeve përmbarimore të gjykatës për paga jubilarë dhe shujta për arsimtarë, duke i paguar ato nga kategoria e investimeve kapitale.

Kjo ka ndodhur për shkak të ekzekutimit të pagesave nga thesari pa dakordim me komunën sidomos pagesave që lidhen me obligimet nga kontrata kolektive.

Ndikimi	Keq klasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategoritë përkatëse të shpenzimeve dhe në paraqitje jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.
Rekomandimi B1	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në bashkëpunim me MF-në që të gjitha pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.
Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)	

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A4 - Mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave të procedurave të prokurimit

Gjetja

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Sipas nenit 4 paragrafi 3 të Ligjit nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, parashihet se nenit 4 të ligjit bazik I shtohet paragrafi i ri me numër rendor 1.75 me tekstin: konfliktet e interesit - çdo situatë ku anëtarët e personelit të autoritetit kontraktues ose të një ofruesi të shërbimeve të prokurimit që vepron në emër të autoritetit kontraktues që janë të përfshirë në kryerjen e procedurës së prokurimit ose të cilët mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes personal financiar, ekonomik apo ndonjë interes tjetër që mund të perceptohet për kompromis të paanshmërisë dhe pavarësisë së tyre në kontekstin e procedurës së prokurimit.

Në pesë (5) procedura të prokurimit kemi vërejtur mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave, si në vijim:

- Në dosjen e tenderit për projektin “Rregullimi i objekteve Shëndetësore - QMF Bare dhe AMF Bajgorë” kontrata e nënshkruar në vlerë 110,231€ si kërkesë tek mundësitë teknike dhe profesionale për një (1) inxhinier të diplomuar ose master të ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv), një (1) inxhinier ose master i diplomuar i elektroteknikes dhe një (1) Inxhinier ose master i diplomuar i ndërtimtarisë hidroteknike janë kërkuar min pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit. Sipas dosjes së tenderit është kërkuar që listës së stafit profesional t’i bashkangjiten dëshmitë mbi kualifikimet dhe përvojën e punës. Nga rishikimi i dokumentacionit kemi vërejtur se nuk është dëshmuar përvoja e punës në përputhje me kërkesat e DT-së, pasi operatori ekonomik ka dorëzuar vetëm CV-të e stafit profesional, duke mos dëshmuar përvojën profesionale;
- Në dosjen e tenderit për projektin “Ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Shipol - Faza e fundit”, kontrata e nënshkruar në vlerë 147,838€, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale është kërkuar që OE duhet të ketë një (1) inxhinier ose master të gjeodezisë me përvojë pune min. katër (4) vite pas diplomimit duke dëshmuar përmes CV, diplomës së noterizuar, dëshmisë për përvojës së punës dhe kontratës së punës. Nga rishikimi i dokumentacionit kemi vërejtur se nuk është dëshmuar përvoja e punës në përputhje me kërkesat e DT-së, pasi operatori ekonomik ka dorëzuar vetëm CV-të e stafit profesional, duke mos dëshmuar përvojën profesionale në mënyrën e kërkuar dhe të përcaktuar në dokumentet e tenderit;
- Në dosjen e tenderit për projektin “Mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore për QKMF - QMF - AMF”, kontrata me vlerë 74,906€, ndër kriteret thelbësore për kualifikim ishte që operatori ekonomik të dëshmonte posedimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, konkretisht: për një (1) serviser të autorizuar për mamografi GMM dhe një (1) serviser

te autorizuar nga prodhuesi për printerin Dryview Carestream. Për dëshmimin e këtyre kapaciteteve, kërkohej prezantimi i një liste të stafit profesional, përfshirë licencat, diplomat, kontratat, CV-të apo parakontrata për ofrimin e këtyre shërbimeve. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, kemi vërejtur se OE nuk kishte prezantuar listën e kërkuar të stafit, dhe për personelin përgjegjës për këto pajisje mungonin CV-të dhe kontratat. Si rrjedhojë, nuk është dëshmuar në mënyrë të plotë përmbushja e kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit;

- Në dosjen e tenderit “Shërbimet e sigurimit fizik dhe sigurimi me sistem alarmi për komunën dhe institucione tjera komunale”, me vlerë të kontraktuar prej 391,420€ si kërkesë në dosje të tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka minimum 20 punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm për kryerjen e projektit si dhe të ketë minimum pesë (5) punëtorë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë nga një kompani e licencuar për trajnimin dhe çertifikimin e punëtorëve në këtë fushë. Komisioni i vlerësimit kishte përzgjedhur si fitues një OE i cili në listën e stafit teknik ka dëshmuar për një punëtor të stafit me çertifikatë për siguri dhe shëndet në punë, roli i të cilit në kompani është menaxher, ndërkaq i njëjti është njëkohësisht punëtor aktiv i Komunës në pozitën (Monitorues i kamerave) në kuadër të Drejtorisë së Administratës. Përfshirja e këtij zyrtari në kompaninë përfituese paraqet rrezik të konfliktit të interesit, pasi ai është njëkohësisht i angazhuar si pjesë e autoritetit kontraktues dhe si pjesë e subjektit ekonomik që ka fituar kontratën publike. Një situatë e tillë çënon parimet e transparencës dhe integritetit në procesin e prokurimit; dhe
- Në dosjen e tenderit për kontratën “Furnizim me kabinete për shkollë”, me vlerë të kontraktuar prej 169,979€, ndër kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional ishte që operatori ekonomik të angazhojë së paku një (1) inxhinier të elektros me përvojë të dëshmuar prej minimum pesë (5) vjetësh pas diplomimit. Dëshmitë e kërkuara për këtë qëllim përfshinin: kopjen e diplomës përkatëse, CV-në e nënshkruar nga inxhinieri, referenca të përvojës së mëparshme, dhe kontratën e punës valide dhe origjinale me ofertuesin. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës fituese, është konstatuar se nuk ishte dëshmuar përvoja e punës pas diplomimit në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit. Përvoja ishte paraqitur vetëm përmes CV-së, pa dëshmi mbështetëse si referenca ose kontrata të mëparshme pune.

Këto mangësi kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit si dhe mungesës së të kontrolleve të brendshme efektive për të siguruar integritetin e procesit të vlerësimit.

Ndikimi

Kualifikimi i operatorëve pa dëshmi të plota dhe valide rrit rrezikun që kontratat t’u jepen kompanive që nuk përmbushin kriteret minimale ligjore dhe teknike, gjë që mund të ndikojë negativisht në cilësinë e realizimit të projekteve, rrezikon integritetin e procesit të prokurimit, si dhe cenon besueshmërinë dhe llogaridhënien e Komunës.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që komisionet e vlerësimit të ofertave të verifikojnë plotësisht dhe në mënyrë të dokumentuar përmbushjen e të gjitha kriterëve kualifikuesë, në përputhje me dokumentet e tenderit. Po ashtu, është e nevojshme të forcohen kontrollet e brendshme dhe mbikëqyrja gjatë fazës së vlerësimit, për të shmangur përzgjedhjen e

operatorëve që nuk përmbushin kriteret ligjore në dosje të tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos verifikim i gjendjes aktuale të pronave komunale

- Gjetja** Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parashihet që Komuna çdo vit duhet të kryej veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.
- Gjatë procesit të auditimit u konstatua se Departmenti i Tatimit në pronë nuk kishte bërë verifikimin e pronave të paluajtshme për qëllime të tatimit në pronë, duke cenuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave që shërbejnë si bazë për përlogaritjen e detyrimeve tatimore.
- Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe organizimi joefikas i proceseve të verifikimit kanë ndikuar në mosrealizimin e plotë të planit të verifikimit të pronave.
- Ndikimi** Mos verifikimi i plotë i pronave rezulton me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe ndikon në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesat në pagesën e faturave

- Gjetja** Sipas nenit 39 të LMFPP-së, përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.
- Gjatë testimit të mostrave, janë evidentuar nëntë (9) raste me vlerë të përgjithshme prej 327,325€ në të cilat pagesat për mallra dhe shërbime nuk janë kryer brenda afatit të përcaktuar me ligj. Vonesat në pagesë variojnë nga 11 deri në 95 ditë pas kalimit të afatit ligjor.
- Vonesat në pagesa kanë ndodhur si rezultat i kontrolleve joadekuate në procesin e ekzekutimit të pagesave, mungesës së fondeve për kontratat e lidhura dhe vonesave në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm.
- Ndikimi** Vonesat në pagesën e faturave, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve, si dhe mund të shkaktojnë kosto shtesë në buxhetin e Komunës në formë të kamatave dhe procedurave përmbartimore.
- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të ndërmarrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm mbi ekzekutimin e pagesave dhe të sigurojë se të gjitha faturat e vlefshme

paguhen brenda afatit prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Realizimi i sasive në kontratat publike kornizë, në mospërputhje me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit

Gjetja

Sipas nenit 17.35 të Rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik, kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në bazë të poentimit.

Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit.

Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK.

Në dy kontrata publike kornizë me çmime për njësi, janë evidentuar raste ku vlera e shpenzuar për një kategori të caktuar ka tejkaluar vlerën e lejuar në bazë të peshimit të kontratës. Bëhet fjalë për kontratat si në vijim:

- Në kontratën “Mirëmbajtja, ngritja dhe revitalizimi i sipërfaqeve të gjelbëruara dhe parqeve në qytet”, me vlerë të planifikuar 1,200,000€, pozicionet 1 dhe 2 ishin të peshuara me 5% të vlerës totale (maksimumi 60,000€). Megjithatë, për këto pozicione janë realizuar shpenzime në vlerë prej 1,098,681€, duke tejkaluar kufirin e lejuar për 1,038.681€; dhe
- Në kontratën “Intervenime emergjente për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera ekstreme”, me vlerë të planifikuar 450,000€, pozicionet 2.1 deri 2.4 ishin të peshuara me 25% të kontratës (maksimumi 112,500€). Megjithatë, për këto pozicione janë realizuar shpenzime në vlerë prej 167,387€, duke tejkaluar kufirin e lejuar për 54,887€.

Tejkalimet kanë ndodhur për shkak të planifikimit të pamjaftueshëm të nevojave gjatë fazës së përgatitjes së tenderit, përcaktimit jo të saktë të peshëve në raport me rëndësinë reale të punëve apo shërbimeve, si dhe për shkak të mungesës së kontrolleve adekuate nga menaxherët e kontratave gjatë fazës së zbatimit.

Ndikimi

Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët, njëherit ka ndikuar në tejkalim të shpenzimeve për pozicione.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, të bëhet një vlerësim i saktë i nevojave reale të komunës gjatë përgatitjes së kërkesave për tender dhe peshët e specifikuar në dosjet e tenderit të reflektojnë rëndësinë dhe vëllimin e pritshëm të shërbimeve që do të kryhen në praktikë. Gjatë zbatimit të kontratës, menaxherët e kontratave të monitorojnë zbatimin

sipas peshëve të miratuara, për të garantuar përputhshmëri të plotë me
kërkesat ligjore dhe objektivat buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 17,504,585€ derisa janë shpenzuar 17,487,299€, apo 99% e buxhetit. Numri i pozitave të aprovuara sipas ligjit të buxhetit ishte 2,007 punonjës, ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarve ishte 1,843.

Çështja A5 - Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore

Gjetja	Sipas nenit 35, pika 3 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik përcaktohet se “Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë”. Gjatë auditimit, kemi vërejtur se në pesë (5) raste është tejkaluar afati ligjor për mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre. Tejkallimet variojnë nga nëntë (9) muaj deri në katër (4) vjet e shtatë muaj më shumë sesa lejohet me ligj. Në drejtorinë e shëndetësisë, procedurat e rekrutimit për këto pozita nuk janë shpallur fare, ndërsa në drejtorinë e arsimit janë ndërmarrë përpjekje për shpalljen e konkurseve për dy pozita, por ato kanë dështuar për shkak të mungesës së kandidatëve të interesuar. Zgjatja përtej afatit ligjor e ushtrimit të detyrës në pozita drejtuese ka ardhur si rezultat i mosndërmarrjes së masave të mjaftueshme nga menaxhmenti për adresimin e situatës dhe mungesës së angazhimit të duhur për mbulimin e këtyre pozitave.
Ndikimi	Mbajtja e pozitave drejtuese me ushtrues detyre përtej periudhës së përcaktuar me ligj përbën shkelje të dispozitave ligjore dhe rrezikon që këto pozita të udhëhiqen nga persona që nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme për atë pozitë.
Rekomandimi A5	Kryetari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar rekrutimin e rregullt për pozitat që aktualisht mbulohen me ushtrues detyre, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik

Gjetja	Sipas nenit 102 pika të Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publik përcaktohet se “Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës”. Nga 51 kontrata të testuara, në 42 raste kontratat nuk ishin të azhurnuara sa i përket koeficienteve dhe elementeve tjera të përcaktuara me Ligjin për zyrtarët publik. Si rrjedhojë, zyrtarët publikë vazhdojnë të kenë kontrata të pa harmonizuara me ligjin dhe rregulloret në fuqi.
---------------	--

Mos azhurnimi i kontratave ka ardhur si rezultat i neglizhencës së zyrtarëve për azhurnimin e tyre, e cila është një kusht paraprak për zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publik në aspektin e kontratave dhe koeficienteve të ri.

Ndikimi

Mos azhurnimi i kontratave të punës dhe mospërputhja me sistemin e ri të koeficienteve ka shkaktuar mosrespektim të kërkesave ligjore dhe njëherit ndikon në mos përfshirjen e saktë të pozitave në strukturën e pagave.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontratat e punës/stafit azhurnohen dhe janë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Zyrtarët Publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime së bashku me komunalitë ishte 4,825,351€, derisa janë shpenzuar 4,247,629€ apo rreth 88% e buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të projekteve, riparimit dhe mirëmbajtjes, blerjen e pajisjeve, shpenzimeve të transportit, etj.

Çështja A7 - Dobësitë në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja	Neni 70.24 pika (f) e Rregullorës nr. 001/2022 për prokurimin publik, parasheh se menaxherët e kontratës duhet "Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik". Në tetë (8)¹ raste janë evidentuar dobësi në menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve, të cilat nuk janë azhurnuar përmes platformës së E-prokurimit. Mos menaxhimi i kontratave përmes sistemit të E-prokurimit ka ndodhur si rezultat i anashkalimit të procedurës së përcaktuar nga rregullorja, për shkak të mungesës së përgjegjësisë administrative nga ana e zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e kontratave.
Ndikimi	Mos azhurnimi i menaxhimit të kontratave përmes sistemit elektronik të e-prokurimit nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit të tjerë të lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin e performancës të kontratave.
Rekomandimi A7	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e menaxhimit të kontratave, duke siguruar që të gjitha kontratat të menaxhohen dhe dokumentohen përmes modulit për menaxhimin e kontratës në sistemin e e-prokurimit në pajtim me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Mitrovicës së Jugut në PFV-të e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 16,229,041€. Kjo vlerë kryesisht përbëhet prej tatimit në pronë në vlerë 10,594,602€, taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë prej 2,074,052€, taksat dhe tarifat e urbanizmit prej 1,364,138€, pagesave për mbeturina për ekonomi familjare 2,150,532€, etj. Gjatë vitit 2024, llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë janë rritur për 1,630,619€ ose 19% krahasuar me vitin 2023.

Çështja B4 - Mos ndërmarrja e veprimeve për arkëtimin e borxheve

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme përcaktohet se Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbareshë kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore që kalojnë shumë 10€.

Në nenin 27 përcaktohet se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Sipas nenit 22 të rregullores nr.02/2019 për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale të Komunës së Mitrovicës së Jugut që e rregullon taksat dhe tarifat për ushtrimin e veprimtarisë afariste parashihet se të gjithë personat fizik dhe juridik që nuk i përgjigjen pagesës së taksave dhe ngarkesave komunale të parapara do të kërkohej ekzekutimi përmes gjykatave kompetente eventualisht përmbareshëve privat për rastet ku lejohet ndërhyrja e përmbareshëve privat.

Gjatë vitit 2024, vlera totale e llogarive të arkëtueshme të komunës ishte 16,299,041€, prej të cilave 10,594,602€ (65%) kanë të bëjnë me tatimin në pronë, ndërsa 2,074,052€ (12%) me tarifat për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike. Pavarësisht kësaj shume të konsiderueshme të borxheve të grumbulluara, komuna nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim konkret ligjor për inkasimin e tyre gjatë vitit 2024, në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe rregulloreve komunale përkatëse.

Mungesa e veprimeve ka rezultuar nga mosangazhimi i vazhdueshëm i njësive përgjegjëse për arkëtimin e të hyrave, si dhe mungesës së një plani të koordinuar për trajtimin e borxheve të pambledhura.

Ndikimi

Mosinkasimi i borxheve të akumuluar ndikon drejtpërdrejt në rënie të nivelit të të hyrave vetanake, duke kufizuar kapacitetin financiar të komunës për realizimin e objektivave të saj zhvillimore, përfshirë edhe investimet në shërbime publike dhe projekte kapitale që varen nga fondet vetanake.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të ndërmarrë masa konkrete për zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë mbledhjen e të hyrave, përfshirë iniciimin e procedurave përmbareshëve ndaj debitorëve në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në legjislacion.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në Komunë të Mitrovicës së Jugut operon me tre anëtarë të stafit - Drejtor i NjAB dhe dy auditorë. Për vitin 2024, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik ku kishte planifikuar gjashtë (6) auditime të rregullta dhe një (1) sipas kërkesës, prej të cilave ishin finalizuar të gjitha auditimet e rregullta të cilat kishin të bënin me Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Sigurinë dhe Emergjencë, Shëndetësisë, Drejtorinë për Zhvillim, Turizmit dhe Integritet Evropian dhe auditimin për procedurat e prokurimit. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 32 rekomandime. Prej tyre 12 ishin zbatuar, 10 ishin në proces dhe 10 të pazbatuara. Periudha e mbuluar në raportet e NjAB kryesisht përfshinte vitin e kaluar deri në kohën e përfundimit të auditimit përkatës. Komiteti i Auditimit kishte mbajtur katër takime përgjatë vitit 2024 ku janë përpiluar edhe procesverbale ku kishte shqyrtuar raportet, gjetjet e NjAB, rekomandimet dhe progresin e tyre.

Çështja B5 - Zbatimi i ulët i rekomandimeve të NjAB-së

Gjetja

Sipas nenit 9 pika 2 të Rregullores QRK 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm diskuton me udhëheqësin e subjektit të sektorit publik dhe komitetin e auditimit lidhur me planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve, që të lehtësohet ndërmarrja e veprimeve efektive për korrigjim.

Ndërsa, sipas nenit 9 pika 7, auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

Në raportet e auditimit të brendshëm të hartuar nga NjAB gjatë periudhës së raportimit, janë dhënë gjithsej 32 rekomandime, nga të cilat ishin zbatuar vetëm 12, dhjetë (10) rekomandime nuk ishin adresuar fare, ndërsa dhjetë (10) të tjera ishin në proces të zbatimit.

Më datë 30.09.2024, drejtori i NjAB-së në bashkëpunim me njësitë buxhetore ka përgatitur një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Më tej, më 14.10.2024, është përgatitur një plan tjetër i veprimit nga Kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtorinë dhe NjAB-në.

Nuk është e qartë se si NjAB ka përcjellë procesin e implementimit të rekomandimeve, pasi për të dhënat e raportuara në NjQHAB lidhur me numrin e rekomandimeve të zbatuara nuk kemi mundur të bëjmë verifikimin real të tyre. Kjo krijon paqartësi mbi besueshmërinë e raportimit të progresit.

Situata është rezultat i mungesës së përkushtimit të njësive të audituara për të adresuar rekomandimet dhe për të përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm. Po ashtu, mungesa e një mekanizmi të dokumentuar dhe të sistematizuar për monitorimin dhe raportimin e progresit të rekomandimeve ka ndikuar në mungesën e një pasqyre të saktë dhe të verifikueshme.

Ndikimi

Zbatimi i ulët i rekomandimeve dëmton besueshmërinë e sistemit të auditimit të brendshëm dhe e kufizon aftësinë për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërmarra nga menaxhmenti. Kjo pamundëson marrjen e vendimeve të informuara dhe rrit rrezikun që dobësitë e njëjta të përsëriten çdo vit pa u adresuar në mënyrë efektive.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha drejtoritë përkatëse të përgatisin dhe të dorëzojnë plane konkrete veprimi për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së. Në të njëjtën kohë, NjAB duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një procedurë të qartë dhe të dokumentuar për ndjekjen dhe raportimin e progresit të zbatimit të rekomandimeve, duke u bazuar në informata të sakta dhe të verifikueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	28,408,510	30,921,061	28,939,149	26,800,882	21,820,579
Grante Qeveritare - Buxheti	25,120,336	26,333,046	25,409,606	22,142,266	18,275,865
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	179,614
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,179,238	1,066,226	1,345,468	1,326,326
Të hyrat vetanake	3,288,174	3,288,174	2,431,929	2,897,727	1,886,661
Donacionet vendore	0	94,154	21,943	29,237	10,687
Donacionet e jashtme	0	26,449	9,446	386,186	141,426

Buxheti final i Komunës së Mitrovicës së Jugut është më i lartë se buxheti fillestar për 2,512,551€ apo 9%. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 1,212,710€, përfshirjes së të hyrave të bartura nga vitet paraprak në vlerë prej 1,179,238€ dhe donacioneve në vlerë prej 120,603€ në buxhet final.

Në vitin 2024, Komuna ka shpenzuar rreth 94% të buxhetit final ose 28,939,149€, me një zvogëlim prej 2% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Vlen të theksohet se Thesari nga kategori të ndryshme ekonomike sipas vendimeve përmbartimore/gjyqësore kishte realizuar pagesa në vlerë 5,042,056€, për obligime të dala nga kontrata kolektive dhe për operatorë ekonomik.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	28,408,510	30,921,061	28,939,149	26,800,882	21,820,579
Pagat dhe mëditjet	15,833,082	17,504,585	17,487,299	14,583,138	12,230,685
Mallrat dhe shërbimet	4,120,909	4,208,550	3,824,127	3,894,431	3,480,368
Komunalitë	616,000	616,801	423,502	487,812	486,757
Subvencionet dhe transferet	1,209,150	1,446,256	1,403,498	2,004,864	1,153,132
Investimet Kapitale	6,629,369	7,144,869	5,800,723	5,830,637	4,469,637

Komuna kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,671,503€. Buxheti final përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 17,374,113€, pastaj nga të hyrat vetanake të bartura prej 73,000€, të hyrave vetanake të bartura prej 41,141€ dhe donacionet e jashtme prej 16,331€. Për periudhën janar - dhjetor 2024 realizimi i buxhetit është 17,487,299€ apo 99.9% e buxhetit final;


- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 87,641€. Pjesa më e madhe e këtij buxhetit përbëhet nga granti qeveritar prej 3,379,894€, të hyrave vetanake prej 741,015€, të hyrave të bartura prej 60,345€ dhe donacionet në vlerë prej 27,296€; Deri në fund të vitit 2024 realizimi i buxhetit ishte 3,824,127€ apo 91% e buxhetit final;

- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 801€ si rezultat i të hyrave të bartura. Ky buxhet përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 616,000€ dhe nga të hyrat vetanake të bartura prej 801€. Deri në fund të vitit realizimi i buxhetit ishte 423,501€ apo 69% e buxhetit final;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 237,106€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 24,991€, të hyrave vetanake prej 1,184,159€, të hyrave vetanake të bartura prej 204,587€ dhe grantit të donacioneve të brendshme prej 32,519€. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte 1,403,498€ apo 97% e buxhetit final; dhe

- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje në vlerë prej 515,500€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 4,938,048€, të hyrave vetanake prej 1,290,000€, të hyrave vetanake të bartura 872,365€ dhe donacioneve prej 44,456€. Deri në fund të vitit Komuna kishte arritur të shpenzoj vetëm 5,800,723€ apo 81% e buxhetit. Vlen të theksohet se vlera prej 2,262,124€ është ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore për kontratë kolektive, paga jubilarë dhe operatorë ekonomik nga kategoria e investimeve kapitale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut në 2024 ishin në vlerë 2,704,990€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, participimet, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike, etj. Për vitin 2024, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 3,288,174€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave ka shënuar zvogëlim prej 993,361€ apo rreth 26%.

Përveç kësaj shume, të hyrat nga gjobat në trafik dhe gjobat nga Gjykatat ishin në shumën 484,982€ të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) të cilat i alokohen Komunës për shpenzim. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e më poshtme, për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	3,288,174	3,288,174	2,704,990	3,698,351	2,996,807
Të hyrat tatimore	1,222,019	1,222,019	1,174,381	1,567,884	1,073,382
Të hyrat jo tatimore	2,066,155	2,066,155	1,527,109	2,129,999	1,923,352
Të hyrat tjera	0	0	3,500	468	72

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Komunës së Mitrovicës së Jugut ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tri (3) rekomandime janë zbatuar; një (1) ishin në proces dhe për pesë (5) rekomandime nuk kishte filluar zbatimi ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Keqklasifikimet - Investimet dhe Vendimet Gjyqesore	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në bashkëpunim me MF-në që të gjitha pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.	Edhe këtë vit ishin procesuar shpenzimet përmes kategorive jo adekuate përmes vendimeve gjyqësore duke shkaktuar keq klasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se për pagesat e bëra në paradhënie do të kërkoj sigurimin e garancionit e performancës dhe orarin e pagesave i cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer.	Gjatë testimit të mostrave në vitin 2024 nuk kemi vërejtur raste të tilla.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Edhe këtë vit, Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e pronave të paluajtshme.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të përmirësojë kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave, dhe pagesat mos të bëhet nga certifikuesi pa u siguruar se janë respektuar të gjitha kushtet e kontratës.	Edhe këtë vit kemi hasur në tejkalim të peshëve të përcaktuara të sasive tek kontratat publike kornizë.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të marrë veprime shtesë për të siguruar se janë bërë korrigjimet e nevojshme në data bazën e tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parsor.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur në raste ku është aplikuar zbritja për prona të paregjistruara dhe tatimpaguesve pa numër personal.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që komisionet e caktuara për inventarizim, të përfshijnë të gjithë pasurinë e komunës.	Gjatë vitit 2024 ishin formuar Komisionet e inventarizimit duke përfshirë të gjitha drejtoritë komunale.	I zbatuar
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të adresojë problemet e lartpërmendura duke ndërmarrë masa ligjore ndaj borxhlinjve sipas kushteve të dakorduara, të trajtohen kontratat e skaduara sipas procedurave të parapara.	Edhe në vitin 2024 kemi vërejtur se Komuna nuk kishte krijuar mekanizma efektiv për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme, kryesisht tek tatimi në pronë.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Edhe këtë vit kemi hasur në vonesa në realizimin e pagesave përtej afatit ligjor.	Nuk ka filluar zbatimin

9.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm do të përcillen me një plan veprimi për implementimin e tyre si dhe një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre.	Nuk janë marrë veprime të mjaftueshme për monitorimin formal të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NjAB.	Nuk ka filluar zbatimi
----	----------------------	--	--	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nora Rashiti Nishefci, Udhëheqëse e ekipit



Kushtrim Leci, Anëtar i ekipit



Ajtene Llapashtica, Anëtare e ekipit



Endrita Gjyrevci, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Bedri HAMZA

(Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut)

Data: 29.maj.2025. Mitrovica



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1. "Mirëmbajtja e paisjeve mjekësore për QKMF - QMF - AMF" kontrata e nënshkruar me datë 11.07.2024, me vlerë 74,906€; 2. "Furnizim me paisje sportive, dyer dhe dritare, inventar shkollor, materiale dhe paisje tjera ne institucione arsimore" kontrata e nënshkruar me datë 07.11.2024, vlerë të parashikuar 124,500€; 3. "Shërbimet e sigurimit fizik dhe sigurimi me sistem alarmi për komunë dhe institucione tjera komunale" kontrata e nënshkruar me datë 12.09.2024, me vlerë 391,420€; 4. "Mirëmbajtja teknike e institucioneve arsimore" kontrata e nënshkruar me datë 05.11.2024, vlerë të parashikuar 295,000€; 5. "Furnizimi me tabela vetdijësuse, shporta për sheshe dhe trotuare, qanta ekologjike dhe shërbimi I dizajnit dhe printimit të materialeve vetdijësuese për mjedis" kontrata e nënshkruar me datë 24.10.2024 me vlerë 17,788€; 6. "Rregullimi i objektit të SHFMU Migjeni - Iliridë", kontrata e nënshkruar më 10.10.24 me vlerë prej 363,882€; 7. "Rregullimi i objekteve shëndetsore - QMF Bare dhe AMF Bajgorë", kontrata e nënshkruar më 21.10.2024 me vlerë prej 110,231€; dhe 8. "Rregullimi i objektit të SHMLM Xheladin Deda" kontrata e nënshkruar më 29.07.2024 në vlerë prej 49,983€.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.